



RAPORTI I PROGRESIT VJETOR 2019

SEKRETARIATI KOMBËTAR NISMA PËR TRANSPARENÇË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE

QERSHOR 2020



PARATHËNIE

Raporti i Progresit Vjetor paraqet ecurinë e veprimtarisë të Grupit Ndërinstitucional të Punës (MSG) dhe të Sekretariatit Kombëtar EITI për periudhën Janar-Dhjetor 2019. Ky raport është një mekanizëm shumë i rëndësishëm që shërben për të trajtuar përparimin e Shqipërisë si vend që implementon standardet në përputhje me kërkesat EITI. Gjithashtu përmes tij ofrohet një mundësi mjaft e mirë për të evidentuar nivelin e transparencës në kuadrin e përdorimit dhe forcimit të menaxhimit të burimeve natyrore në përputhje me standardet EITI.

Në Nëntor të vitit 2019 kur mora detyrën time si Drejtues i Sekretariatit Kombëtar EITI isha i vetëdijshëm që së bashku me pjesën tjetër të stafit të Sekretariatit dhe anëtarët e MSG do të përballësia me problematika të mbartura por dhe me shumë sfida të reja. Për rrjedhojë duke gjetur mbështetjen e veçantë të institucionit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe të gjithë aktorëve që veprojnë në fushën e transparencës në industrinë nxjerrëse kemi arritur të superojmë në kohë reale disa problematika të cilat mund të bëheshin pengesë në vijim për zhvillimin e aktiviteteve të Sekretariatit Kombëtar EITI. Si një domosdoshmëri, jo vetëm për institucionin, por edhe për kalimin në një stad të ri, ndoqëm me prioritet të mënjëherëshëm shtyrjen e Grantit të Bankës Botërore (TF 0A6493) dhe përmbylljen e procedurës së prokurimit lidhur me përzgjedhjen e Administratorit të Pavarur për përgatitjen e Raportit EITI 2017-2018 dhe gjithashtu nisjen e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Punës për vitin në vijim. Ndërkohë viti 2019 është karakterizuar nga disa aktivitete me karakter institucional që janë realizuar me kontributin e ekspertëve lokale dhe të huaj, me qëllim për ta përqasur veprimtarinë e Sekretariatit me thelbin e misionit të tij që konsiston në promovimin dhe implementimin e procesit të Transparencës në Industrinë Nxjerrëse.


Krijimi i një regjistri i cili do të zbardhë emrat e Pronarëve Realë dhe aksesueshmërinë mbi të dhënat e subjekteve është një ndër prioritetet e punës tonë gjatë vitit 2020. Sekretariati Kombëtar EITI dhe Grupi Ndërinstitucional i Punës (MSG) do të bashkëpunojnë ngushtësisht për ta bërë të zbatueshëm këtë aktivitet në vijim. Do të doja të theksoja se e ardhmja e procesit të transparencës në fushën e industrisë nxjerrëse është e lidhur domosdoshmërisht nga forcimi i partneritetit trepalësh ndërmjet qeverisë, biznesit dhe shoqërisë civile ku të gjithë bashkë do mundësojmë realizimin e misionit tonë të përbashkët në implementimin e standardeve në përputhje me kërkesat EITI.

GENCI TËRPO



NJË VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS NË 2019

NË PËRPUTHJE ME KËRKESËN 7.4 (a) (i)





Gjatë vitit 2019 u organizuan pesë mbledhje të Grupit Ndërinstitucional të Punës (MSG). Në këto mbledhje janë diskutuar dhe shqyrtuar Finalizimi i Veprimeve Korigjuese të dala nga Misioni i Validimit; Fillimi i procedurës për emërimin e Antarëve të rinj të grupimit të Shoqërisë Civile; Vlerësimi Vjetor për anëtarët e MSG-së; Mbi finalizimin e projektit pilot për Commodity Trading dhe adresimi i rekomandimeve të lëna nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI; Adresimi i problematikave të Rentës Minerare dhe manaxhimi efektiv i të ardhurave në nivel Lokal; Diskutim mbi prioritetin e publikimit të Pronarëve Reale (BO) brënda afateve zyrtare të përcaktuara nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI; Prezantimi i antarëve të rinj të MSG-së; Diskutim mbi ekzistencën dhe materialitetin e shpenzimeve 'quasi fiscale'; Rishikimin e Standartit EITI ndaj propozimeve të Sekretariatit Ndërkombëtar; Ngritja e Grupit të Punës për ndjekjen në vijimësi të rekomandimeve të lëna nga Misioni i Validimit dhe i Rekomandimeve të Raportit EITI; Takim me Misionin e Bankës Botërore në Tiranë për diskutimin e prioriteteve EITI dhe vizionit të qëndrueshëm sektorial; Prezantimi i Drejtuesit të ri të Sekretariatit dhe problematikave të lidhura me prioritetet e implementimit dhe aktivitetet EITI në Shqipëri.

Sekretariati Kombëtar EITI gjatë vitit pati ndryshime në nivel Drejtuesish.


Në muajin Shkurt prezantohet Kryetari i ri i Grupit Ndërinstitucional të Punës, Zëvendësministri i Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës z. Ilir Bejtja dhe në muajin Nëntor prezantohet Drejtuesi i ri i Sekretariatit Kombëtar EITI z. Genci Tërpo.

Me rëndësi të veçantë, gjatë periudhës 2019, ishte edhe nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkëpunim ndërmjet Sekretariatit dhe Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, OSBE – Prezenca në Shqipëri, në nxitjen e Transparencës dhe sensibilizimit publik në funksion të mirëqeverisjes të Burimeve Natyrore si dhe Studimi i menaxhimit, shpërndarjes dhe transparencës së të ardhurave në nivel vendor nga Renta Minerare, si dhe adresimin e impaktit mjedisor dhe social nga aktiviteti Industrisë Nxjerrëse.



AKTIVITETE NË 2019

SHKURTIMISHT



Gjatë vitit 2019, Grupi Ndërinstitucional i Punës dhe Sekretariati Kombëtar EITI kanë organizuar takime me institucione/organizata ndërkombëtare dhe lokale në mbështetje të Inicativës EITI në Shqipëri.

WORKSHOP MBI BASHKËPUNIMIN NDËRMJET SEKRETARIATIT KOMBËTAR DHE SEKRETARIATIT EITI UKRAINË NË ZBULIMIN E PRONARËVE REALË

16-18 DHJETOR

Ukraina, si një ndër vendet që krijoi regjistrin e parë në botë të Pronarëve Realë (Beneficial Ownership), për personat juridikë dhe regjistrin e pasurive për zyrtarët qeveritarë, u organizua një vizitë tre ditore pune në Kiev nga përfaqësues të Sekretariatit Kombëtar EITI dhe të Shoqërisë Civile, antarë të Grupit Ndërinstitucional të Punës (MSG). Në kuadër të kësaj vizite u realizuan takime me Drejtues dhe përfaqësues të Sekretariatit EITI Ukrainë, Specialistë të Bankës Kombëtare të Ukrainës, Qendrës së Veprimit Kundër Korrupsionit, Antarë të Shoqërisë Civile, përfaqësues të Shërbimit Shtetëror të Hetimit Financiar, Youcontrol, si dhe me kryetaren e Këshillit të Koordinimit të Partneritetit të Qeverisë së Hapur. Z. Genci Tërpo, Drejtues i Sekretariatit Kombëtar EITI, vlerësoi z. Oleksiy Orlovsky, anëtar i Bordit Ndërkombëtar EITI dhe znj. Dina Narezheva, Manaxhere në International Renaissance Foundation që mundësuan dhe organizuan takimet bilaterale dhe se ekzistojnë mundësi për të rritur bashkëpunimin e ndërsjellë mes dy Sekretariateve EITI, në mbështetje të çështjeve dhe specifikave mbi deklarimin e Pronarëve Realë (Beneficial Ownership).

Z.Tërpo theksoi gjatë takimeve hapat që do të ndërmerren nga Sekretariati Kombëtar EITI në vijim të aktiviteteve të përcaktuara për evidentimin dhe pasqyrimin e Pronarëve Realë (Beneficial Ownership) në fushën e industrisë nxjerrëse në Shqipëri duke ju referuar edhe praktikës së Ukrainës në këtë drejtim.

Znj. Anila Hajnaj dhe Znj. Ola Mitre, përfaqësues të Shoqërisë Civile, antarë të Grupit Ndërinstitucional të Punës (MSG),vunë theksin tek roli që duhet të luaj Shoqëria Civile si një 'sektor i tretë' i shoqërisë, i dallueshëm nga qeveria dhe biznesi.

Publikimi i Pronarëve Realë (Beneficial Ownership) në 2020 si një nga kërkesat themelore të EITI Ndërkombëtar ka nxitur palën Shqiptare, konkretisht Ministrinë e Financave dhe

Ekonomisë në hartimin/draftimin e një ligji të ri që synon të krijojë një regjistër i cili do të zbardhë emrat e Pronarëve Realë dhe aksesueshmërinë mbi të dhënat e subjekteve.

Link: <http://www.albeiti.org/workshop-mbi-bashkepunimin-ndermjet-sekretariatit-kombetar-dhe-sekretariatit-eiti-ukraine-ne-zbulimin-e-pronareve-reale/>

TAKIM PËR IMPAKTIN E RENTËS MBI ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

19 NËNTOR

Sekretariati Kombëtar EITI, Prezenca e OSBE në Shqipëri dhe Agjensia për mbështetjen e Vetë-Qeverisjes Vendore organizuan takimin në nivel Teknik për Impaktin e Rentës në Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Përfaqësuesja e Misionit të OSBE në fjalën e saj në takim theksoi rolin shumë të rëndësishëm të procesit për hartimin e Platformës së Rentës Minerare, në koordinim të ngushtë me njësitë e pushtetit lokal, si pjesë e Platformës për Zhvillim afatgjatë të zonave me aktivitet nxjerrës.

Drejtoresha Ekzekutive e Shoqatës për Autonominë Vendore theksoi në takim rëndësinë që ka rishikimi i vlerës së rentës minerare në funksion të impaktit sektorial dhe mbështetja për optimizimin nga ana e Bashkive të adresimit të problematikave që lidhen me rentën dhe industrinë nxjerrëse.

Përfaqësuesi i Sekretariatit Kombëtar EITI diskutoi mbi fokusin e aktivitetit EITI në Zhvillimin e Qëndrueshëm në zonat dhe komunitetet ku ushtrojnë aktivitet operatorët e industrisë nxjerrëse, duke vënë theksin mbi rëndësinë e shfrytëzimit prudent dhe transparent të burimeve natyrore dhe impaktin socio-ekonomik dhe mjedisor të tyre.

Link: <http://www.albeiti.org/takim-per-impaktin-e-rentes-mbi-zhvillimin-e-qendrueshem/>

MINERARE

30 TETOR

Në katër Bashkitë Peshkopi, Bulqizë, Mat dhe Klos ushtrojnë aktivitet kompani për 156 Leje Minerare për prodhimin e Kromit, si dhe 7 kompani në nxjerrjen e gurit gëlqeror, gëlqeror i mermerizuar, alabaster etj.

Përfaqësuesi i Misionit të OSBE bëri një prezantim të detajuar të procesit të Platformës së Rentës Minerare për koordinim të ngushtë me njësitë e pushtetit lokal dhe Institucionet qendrore pjesë integrale e këtij procesi, nën mbështetjen aktive të Misionit të OSBE. Nga ana e përfaqësuesve të Bashkive u formuluan shqetësime konkrete që lidhen me impaktet mjedisore dhe infrastrukturore të aktiviteteve të industrisë nxjerrëse, si dhe nevojën e marrjes në konsideratë në ndryshimin e kuadrit ligjor lidhur me të ardhurat që duhet të përfitojnë Bashkitë nga aktiviteti Koncesionar në HEC-et që janë në aktivitet në territoret që mbulohen nga këto Bashki. Në Workshop përfaqësuesit e Sekretariatit Kombëtar EITI diskutuan mbi potencialet dhe avatazhet e rritjes së bashkëpunimit të Njësive të qeverisjes vendore me Sekretariatit Kombëtar Alb-EITI, në procesin e raportimit që lidhet me Transparencën për maksimizimin e impaktit social dhe mjedisor të Rentës Minerare në komunitetet lokale si dhe Forcimin e kapaciteteve lokale në kuadrin e një Platforme të zhvillimit afatgjatë të Zonave me Industri Nxjerrëse, e cila është inicuar nga Qeveria Shqiptare.

Link: <http://www.albeiti.org/takimi-4-tematik-nder-vendor-bulqize-industria-minerare-dhe-ceshtje-te-rentes-minerare/>

TAKIM ME AMBASADORIN E BRAZILIT- INTERES DHE VLERËSIM PËR IMPLEMENTIMIN EITI

27 SHTATOR

Me kërkesë të Ambasadës së Brazilit në Tiranë, u zhvillua një takim pune ndërmjet Ambasadorit të Brazilit z. Francisco Carvalho Chagas dhe Drejtuesit të Sekretariatit, në kuadrin e interesimit dhe vlerësimit të avantazheve të implementimit të standarteve ndërkombëtare EITI.

Ambasadori Chagas shprehu gjatë takimit interesin për të konceptuar inicimin e procesit të përfshirjes të Brazilit në Inicativën Globale EITI.

Shqipëria është i vetmi vend në Rajon anëtar i Inicativës Globale EITI dhe në këtë kontekst Alb -EITI shpreh gadishmërinë e plotë për të ofruar eksperiencën dhe asistencën e tij, për të gjithë partnerët ndërkombëtarë që planifikojnë të iniciojnë procesin e implementimit të standarteve EITI.

Link: <http://www.albeiti.org/takim-me-ambasadorin-e-brazilit-interes-dhe-vleresim-per-implementimin-eiti/>

WORKSHOP-I I TRETË NDËRVENDOR TEMATIK PËR PROBLEMATIKAT E RENTËS MINERARE

25 SHTATOR

Në Workshop morën pjesë Përfaqësues të Sekretariatit dhe MSG EITI-Shqipëri, përfaqësues të Prezencës OSBE, titullarë dhe stafe të Bashkive Berat, Kuçovë, Skrapar, Ura Vajguore; Përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, Ministrisë së Drejtësisë, ADISA, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, AKBN, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Përkrahjes Sociale/Agjensisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Shoqërisë Civile, FIAA, ekspertë të kontraktuar nga OSBE etj.

Në katër Bashkitë respektive ushtrojnë aktivitet kompani për 59 Leje Minerare (në nxjerrjen e gurit gëlqeror, ranor silicor, gëlqeror i mermerizuar, gurë dekorativë etj); si dhe në sektorin Hidrokarbur Kompania “Shell Upsteram Albania B.V.” në fazën e kërkim-zbulimit dhe në fazën e shfrytëzimit kompania “Sherwood International Petroleum” Ltd dhe kompania “Albpetrol” sha.

Drejtuesja e Departamentit të Qeverisjes së Mirë në Prezencën e Misionit të OSBE theksoi angazhimin e OSBE për të përkrahur një proces transparent të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe me impakte optimale mjedisore dhe sociale të aktivitetit të Industrisë Nxjerrëse në njësitë dhe komunitetet lokale.

Link: <http://www.albeiti.org/workshop-i-i-trete-nder-vendor-tematik-per-problematikat-e-rentes-minerare/>

TAKIME ME PËRFAQËSUESIT E BASHKIVE BERAT, KUÇOVË, URA VAJGURORE DHE SKRAPAR

2-3 SHTATOR

Sekretariatit Kombëtar AlbEITI dhe Prezenca e OSBE organizuan një cikël takimesh konsultative. Në takimet me përfaqësuesit e secilës prej të katër Bashkive u diskutuan në formë të detajuar problematika që kanë të bëjnë me: Shpërndarjen dhe maksimizimin e impaktit social dhe mjedisor të Rentës në komunitetet përfituese; Problematikat që lidhen me efektet mjedisore të aktiviteteve nxjerrëse; Forcimin e kapaciteteve lokale në funksion të shfrytëzimit të instrumenteve ligjore në luftën kundër informalitetit; Ndjekja e hapave të plota proceduriale për heqjen nga fondi pyjor-kullor i sipërfaqeve të lejeve të shfrytëzimit mineral konform legjislacionit në fuqi; Impakti i aktiviteteve të Industrisë Nxjerrëse në infrastrukturën rrugore etj.

Link: <http://www.albeiti.org/takime-me-perfaqesuesit-e-bashkive-berat-kucove-ura-vajguore-dhe-skrapar-2/>

KONFERENCA GLOBALE EITI-PARIS 2019

17-19 QERSHOR

Nën logon "Open Data Build Trust -Të dhënat e Hapura Ndërtojnë Besimin", u organizua Forumi më i madh botëror 3- vjeçar periodik i EITI Ndërkombëtar, me pjesëmarrje shumë të gjerë të mbi 1.000 përfaqësuesve nga 98 shtete të ndryshme,

Shqipëria u përfaqësua në këtë event global nga një delegacion me përbërje nga MSG dhe Sekretariati Kombëtar Alb-EITI, përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësues të Shoqërisë civile dhe Bizneseve të Industrisë Nxjerrëse, si dhe përfaqësues të Misionit të OSBE në Shqipëri.

Konferenca Globale EITI Paris 2019 në mënyrë evidente reflektoi rëndësinë shumë të madhe të implementimit dhe promovimit të Transparencës në sektorët e Industrisë Nxjerrëse, si një nga mekanizmat më eficientë dhe të garantuara për maksimizimin e përfitimit publik nga burimet natyrore dhe evidentimin e EITI si një platformë shumë efikase e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërkombëtar, për luftën ndaj korrupsionit dhe informalitetit, si dhe përmirësimin e sistemeve qeveritare në funksion të mirëadministrimit të burimeve natyrore.

Gjatë sesioneve të Konferencës u prezantua formati i ri i Standartit EITI 2019, ku inkludohen përmirësime të cilat përfshijnë: Raportimin për Impaktin Mjedisor, Transaksionet e Ndërmarrjeve Shtetërore; Transparenca e Kontrateve; Balanca Gjimore në proçeset EITI; si dhe Raportimi i disintegroar i Kontratave.

Gjatë punimeve në Konferencë u zhvillua Mbledhja 43- të e Bordit Ndërkombëtar EITI, ku u evidentuan edhe rezultatet e proçesit të Validimit të Dytë ndërkombëtar EITI për progresin e Shqipërisë të zhvilluar në Prill 2019.

Link: <http://www.albeiti.org/konferenca-globale-eiti-paris-2019/>

EITI-OSBE: WORKSHOP I DYTË NDËRVENDOR ME BASHKITË E JUGUT

30 MAJ

EITI dhe Prezenca e OSBE organizuan në Bashkinë Vlorë Workshop-in e Dytë Ndër-Vendor me Tematikën: Impakti i Rentës Minerare në komunitetet Lokale. Drejtuesja e Departamentit të Qeverisjes së Mirë në Prezencën e Misionit të OSBE si dhe përfaqësues të OSBE prezantuan prioritetet dhe skenarët e OSBE për një zhvillim të qëndrueshëm, transparent dhe me impakte optimale mjedisore dhe sociale të aktivitetit të Industrisë Nxjerrëse. Kryetari i Bashkisë Vlorë prezantoi problematikat që lidhen me impaktet reale që ka zhvillimi i aktivitetit të Industrisë Nxjerrëse në infrastrukturën vendore dhe në aspektin mjedisor në qytetin e Vlorës, duke vënë në vëmendjen rëndësinë që ka optimizimi i zhvillimit të aktiviteteve të Industrisë Nxjerrëse, me rëndësinë turistike të qytetit bregdetar.

Link: <http://www.albeiti.org/eiti-osbe-workshop-i-dyte-ndervendor-me-bashkite-e-jugut/>

EITI NË FORUMIN EKONOMIK DHE MJEDISOR TË OSBE ME TEMË 'PROMOVIMI I SIGURISË DHE PROGRESIT EKONOMIK NDËRMJET KOOPERIMIT ENERJITIK DHE KONEKTIVITETIT

27-28 MAJ

Në Bratislavë, Sllovaki, u organizua Forumi Ekonomik dhe Mjedisor dhe me ftesë të OSBE u përfaqësua edhe EITI Shqipëri. Sekretariati Ndërkombëtar i Kartës së Energjisë prezantoi në këtë Forum botimin zyrtar të Sekretariatit EIRA 2018, mbi Vlerësimin e Riskut në Sektorin Energjitik dhe Sigurinë Energjitike në shtetet anëtare të Kartës së Energjisë. Shqipëria në këtë Raport zyrtar klasifikohet me risk të ulët në sektorin Energjitik dhe theksohet se në komponentin e Transparencës Shqipëria vlerësohet me një pikëzim shumë të lartë 83 pikë, duke lënë pas shumë shtete të tjera në klasifikimin për Transparencën në sektorin Energjitik si: Kroacia, Greqia, Bosnja, Hungaria, Mali i Zi etj.

Link: <http://www.albeiti.org/eiti-ne-forumin-ekonomik-dhe-mjedisor-te-osbe-me-teme-promovimi-i-sigurise-dhe-progresit-ekonomik-nepermjet-kooperimit-energjitik-dhe-konektivitetit/>

EITI-OSBE: CIKËL TAKIMESH NDËRVENDORE NË KATËR BASHKI TË JUGUT

20-21 MAJ

EITI dhe Prezenca e OSBE organizuan një cikël takimesh pune në katër Bashki të Jugut, takime që u fokusuan në diskutimet lidhur me marrëdhëniet e pushtetit vendor me kompanitë që ushtrojnë aktivitet në Indistrinë Nxjerrëse, si dhe për të trajtuar impaktin ekonomik-social dhe mjedisor të këtyre aktiviteteve në komunitetet lokale dhe në efektivitetin e potencialeve turistike në disa prej këtyre Bashkive.

Link: <http://www.albeiti.org/eiti-osbe-cikel-takimesh-ndervendore-ne-kater-bashki-te-jugut/>

EITI NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN INTEGRAL TË INDUSTRISE MINERARE ME NDIKIM MINIMAL NË MJEDIS

10 MAJ

Konferenca Ndërkombëtare trajtoi problematika që lidhen me prezantimin e potencialeve minerare të dy vendeve, Politikat dhe strategjitë për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit, Minimizimin e impakteve negative në mjedis nga aktiviteti minerar, si dhe forcimin e bashkëpunimit real Shqipëri-Kosovë në sektorin Minerar. Në fjalën që mbajti nga ana e Sekretariatit Kombëtar EITI u theksua rëndësia e promovimit dhe implementimit të procesit të Transparencës në aktivitetin Minerar, si dhe roli aktiv të Alb-EITI për bashkëpunimin me strukturat shtetërore të Kosovës, lidhur me inicimin e procesit të anëtarësimit të Kosovës në Iniciativën Ndërkombëtare EITI.

Link: <http://www.albeiti.org/eiti-ne-konferencen-nderkombetare-per-zhvillimin-integral-te-industrise-minerare-me-ndikim-minimal-ne-mjedis/>

EITI-OSBE: WORKSHOP I PARË NDËRVENDOR ME PUSHTETIN LOKAL LIDHUR ME PROBLEMATIKAT E RENTËS MINERARE

9 MAJ

Në workshop-in e parë ndërvendor me pushtetin lokal, përfaqësues nga Bashkia Fier dhe Patos prezantuan vlerat e të ardhurave që gjenerohen nga Renta Minereare në këto Bashki, si dhe diskutua me përfaqësuesit e MFE lidhur me përlllogaritjen dhe minimizimin e vonesave që shkaktohen në shperndarjen e Rentës minerare, si dhe propozimet konkrete për optimizimin e këtij procesi.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjensisë për Mbështetjen e Vetë-Qeverisjes Vendore, prezantoi procesin e inicimit nga Qeveria Shqiptare për hartimin e një Platforme Afatgjate, për

Zhvillimin e Zonave me aktivitet në Industrinë nxjerrëse dhe Përpunuese, nëpërmjet një Grupi Ndërministror Pune.

Përfaqësuesi i OSBE prezantoi në workshop problematikat që lidhen me bashkëpunimin ndërvendor lidhur me shpërndarjen e rentës në nivel lokal.

Link: <http://www.albeiti.org/eiti-osbe-workshop-i-pare-ndervendor-me-pushtetin-lokal-lidhur-me-problematikat-e-rentes-minerare/>

EITI-OSBE: TAKIME TEKNIKE RAJONALE PËRGATITORE

25 PRILL

Pas nënshkrimit të Memorandumit të bashkëpunimit, Sekretariati Kombëtar EITI dhe Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunim në Evropë, OSBE-Prezenca në Shqipëri, organizuan një seri takimesh teknike Rajonale përgatitore, në bashkitë më të mëdha naftë mbajtëse: Patos, Roskovec dhe Fier. Këto takime u organizuan në funksion të evidentimit të objektivave strategjike rajonale, në mirëmanaxhimin e rentës minerare.

Link: <http://www.albeiti.org/eiti-osbe-takime-teknike-rajonale-pergatitore/>

MISIONI I BANKËS BOTËRORE NË TIRANË PËR DISKUTIMIN E PRIORITETEVE EITI DHE VIZIONIT TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM SEKTORIAL

11-12 PRILL

Përfaqësuesit e Misionit të Bankës Botërore në takimin me Sekretariatit Kombëtar EITI, diskutuan mbi ecurinë dhe progresin e Grantit të Bankës Botërore, në suport të aktivitetit EITI në Shqipëri, si dhe mbi perspektivat reale të vijimit të këtij bashkëpunimi. Misioni i Bankës Botërore gjatë takimit me antarët e MSG, bënë një Prezantim të detajuar të eksperiencave të financimeve të suksesshme ndërkombëtare të Bankës Botërore, të cilat kanë ndihmuar sistematizimin e proçeseve EITI, si dhe mirëqeverisjen sektoriale (ku inkludohen proçeset e

liçensimeve, mbledhja dhe alokimi i të ardhurave nga industria nxjerrëse etj.), në mbështetje të proçeseve EITI.

Link: <http://www.albeiti.org/mision-i-bankes-boterore-ne-tirane-per-diskutimin-e-prioriteteve-eiti-dhe-vizionit-te-zhvillimit-te-qendrueshem-sektorial/>

NËNSHKRIM MEMORANDUM MIRËKUPTIMI PËR BASHKËPUNIMIN NDËRMJET SEKRETARIATIT KOMBËTAR EITI DHE PREZENCËS SË OSBE NË SHQIPËRI

2 PRILL

Në ambjentet e OSBE në Tiranë, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për Bashkëpunimin ndërmjet Sekretariatit Kombëtar Alb-EITI dhe Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, OSBE – Prezenca në Shqipëri.

Memorandumi u nënshkrua nga Ambasadori i OSBE në Shqipëri dhe Drejtori i Sekretariatit Kombëtar EITI.

Platforma e bashkëpunimit institucional konsiston në nxitjen e Transparencës dhe sensibilizimit publik për mirëqeverisjen e Burimeve Natyrore si dhe në ndërtimin e kapaciteteve të autoriteteve të pushtetit vendor.

Link: <http://www.albeiti.org/nenshkrim-memorandum-mirekuptimi-per-bashkepunimin-ndermjet-sekretariatit-kombetar-eiti-shqiperi-dhe-prezences-se-osbe-ne-shqiperi/>

TAKIM MES PËRFAQËSUESVE TË AMBASADËS ZVICERIANE NË SHQIPËRI, MSG DHE SEKRETARIATIT KOMBËTAR EITI

29 SHKURT

Sekretariatit Kombëtar EITI Shqipëri bëri një ekspozë të detajuar të aktivitetit për implementimin e EITI-t në Shqipëri dhe të punës së bërë nga MSG-ja Shqiptare dhe Sekretariatit Kombëtar EITI, me fokus në promovimin e Transparencës në proçesin e mirëadministrimit të të ardhurave që burojnë nga sektorët e Hidrokarbureve, Minierave dhe

Hydroenergjisë në Shqipëri. Përfaqësuesja e Organizatave të Shoqërisë Civile në MSG-ë Shqiptare EITI, paraqiti punën e bërë nga Shoqëria Civile në kuadër të EITI-t dhe bëri një ekspozitë të Projektit të financuar nga Ambasada Zvicerane mbi Rentën Minerare.

Link: <http://www.albeiti.org/takim-mes-perfaqesuesve-te-ambasades-zvicerane-ne-shqiperi-msg-dhe-sekretariatit-kombetar-eiti/>

TAKIM NË KUADRIN E PROÇESIT TË VALIDIMIT TË DYTË NDËRKOMBËTAR TË AKTIVITETIT EITI NË SHQIPËRI

18 MARS

Në kuadrin e proçesit të Validimit të dytë Ndërkombëtar të aktivitetit EITI në Shqipëri, u realizuan takime me përfaqësuesit e Misionit të Validimit nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI në Oslo. Misioni i Validimit realizoi në ambjentet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë takime me Kryetarin e MSG dhe anëtarë të MSG, me përfaqësues të Institucioneve qendrore, përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile, përfaqësues të Pushtetit Lokal; Shoqatën e Investitorëve të Huaj në Shqipëri, AKBN, Albpetrol sha, përfaqësues të Donatorëve dhe Partnerëve Ndërkombëtare, si dhe përfaqësues të Ambasadave të huaja të akredituara në Shqipëri.

Link: <http://www.albeiti.org/procesi-i-validimit-te-dyte-nderkombetar-te-aktivitetit-eiti-ne-shqiperi/>

SHOQËRIA CIVILE, ROLI I SAJ NË TRANSPARENCËN E INDUSTRISË NXJERRËSE

11-12 SHKURT

Sekretariati Kombëtar EITI mori pjesë në Workshop-in me temë "Shoqëria Civile, roli i saj në Transparencën e Industrisë Nxjerrëse", të organizuar në Tiranë nga Qendra Shqiptare për Zhvillimin dhe Integrim (pjesë e MSG – EITI), në bashkëpunim me Sekretariatit Zviceran të Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO, Ambasadën Zviceriane në Tiranë. Në Workshop u prezantuan tematika me fokus në: Programi i involvimit të Shoqërisë Civile në proçesin e Shfrytëzimit të burimeve Natyrore si dhe në aktivitetin EITI në Shqipëri; Renta dhe komunitetet

lokale; Regjimi Fiskal dhe manaxhimi i të ardhurave; Të Drejtat e komunitetit në çështjet sociale dhe mjedisore; Përfituesit Realë; Kodi i Sjelljes të OSHC në procesin EITI; Detyrimet e subjekteve dhe kompanive që shfrytëzojnë burimet natyrore etj. Në ditën e dytë të eventit, pas trainimit me përfaqësues të SHC, u organizua edhe procesi i Zgjedhjeve të përfaqësuesve të organizatave të Shoqërisë Civile si anëtarë të rinj të MSG -EITI, në funksion të adresimit të Corrective Actions 1.3 dhe 1.4, si dhe në konformitet me procedurat e Standartit Ndërkombëtar EITI.

Link: <http://www.albeiti.org/shoqeria-civile-rol-i-saj-ne-transparencen-e-industrise-nxjerrrese/>

QËNDRA SHQIPTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM, PËRFAQËSUES NË GRUPIN NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS (MSG) BËHET PJESË E STRATEGJISË SË BASHKËPUNIMIT ZVICERIAN NË SHQIPËRI

6 SHKURT

Shoqëria civile e mbështetur nga SECO-Ambasada Zvicerane nëpërmjet projektit mbi "Fuqizimin e shoqërisë civile në procesin e EITI-t në Shqipëri, mundi të organizojë zgjedhjet e reja të anëtarëve të MSG-së. Gjithashtu sondazhi i kryer në fazën e parë të projektit në 10 bashki që i referohej vlerësimit të njohurive dhe kuptimit të EITI-t e që lidhen me përfitimet dhe detyrimet e shoqërisë civile, popullsisë dhe aktorëve të tjerë nxorri konkluzione dhe propozoi rekomandime për të katër aktorët kryesorë që marin pjesë në procesin e EITI-t (shih Hulumtim mbi njouritë dhe kuptimin e EITI-t (resurse <http://albneteti.org/>).

Informacioni i mbledhur nga zondazhi u përdor për të hartuar strategjinë e OJF-ve në EITI me qëllim zgjerimin e koalicionit AlbNet-EITI për të arritur në zonat ku shfrytëzohen burimet natyrore me anëtare të cilët janë të interesuar të punojnë në fushën e transparencës së burimeve natyrore.

Gjithashtu anetarja e shoqëria civile në MSG, nëpërmjet monitorimit të rentës minerare në 5 bashki projekt i mbështetur nga SDC-Ambasada Zvicerane dhe "Lëviz Albania" bëri të mundur të identifikojë problematikat e rishpërndarjes së saj, zbatimit të procedurave sipas

ligjit, kuadrit ligjor etj. Raporti mbi renten minerare dhe rekomandimet e tij (resurse <http://albneteiti.org/>), shërbyen për përmirësimin e dukshëm në zbatimin e mëtejshëm të procedurave dhe alokimin e rentës që reflektuan në më shumë të ardhura por gjithashtu edhe si bazë e strategjisë së OSBE dhe dokumentit politik mbi rentën.

Anëtarë të Shoqërisë civile në MSG janë bërë tashmë pikë referimi për informacione jo vetëm për anëtarët e koalicionit AlbNet-EITI por edhe për institucionet e pushtetit vendor ku shfrytëzohen burimet natyrore.


Link: <http://www.albeiti.org/qendra-shqiptare-per-zhvillim-dhe-integrim-perfaqesuese-ne-grupin-nderinstitucional-te-punes-msg-behet-pjese-e-strategjise-se-bashkepunimit-zvicerian-ne-shqiperi/>

RRITJA E SINERGJISË ME INVESTITORËT NDËRKOMBËTARË NË PROÇESIN E TRANSPARENCËS

22 JANAR


Takimi me përfaqësues të SHELL Upstream ALBANIA B.V (degë e Royal Dutch Shell) u vlerësua si një bashkëpunim për rritjen e sinergjisë në proçesin e Transparencës ndërmjet strukturave shtetërore dhe investitorëve ndërkombëtar prestigjozë dhe si një gfaranci për promovimin e një klime atraktive për investime e huaja dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në Shqipëri.

Link: <http://www.albeiti.org/per-rritjen-e-sinergjise-me-investitoret-nderkombetare-ne-procesin-e-trasparences-takim-me-drejtorin-e-ri-te-pergjithshem-te-shell-upstream-albania-z-rohan-dsouza/>



**VLERËSIMI I PERFORMANCËS KUNDREJT OBJEKTIVAVE DHE
AKTIVITETEVE TË PËRCAKTUARA NË PLANIN E PUNËS TË SEKRETARIATIT
EITI SHQIPËRI**

NË PËRPTHJE ME KËRKESËN 1.5 DHE KËRKESËN 7.4 (a) (iv)



OBJEKTIVI ■ **RAPORTI EITI 2017 DHE 2018**

Për shkak të vonesave objektive të fondeve të financuara nga BB, finalizimi i procedurës së prokurimit për Administratorin e Pavarur për përgatitjen e Raportit EITI 2017-2018, u finalizua në Janar 2020 dhe është lidhur kontrata me Deloitte Albania sh.p.k e cila është duke punuar për finalizimin e këtyre dy raporteve.

OBJEKTIVI ■ **VALIDIMI**

Në fund të Majit 2019 është marrë Raporti Final i Vlerësimit nga Validuesit dhe në datë 17 qershor 2019 është marrë vendimi nga Bordi Ndërkombëtar EITI për Validimin e II të Shqipërisë.



Në muajin Janar 2020, MSG ka diskutuar dhe janë sygjeruar hapat që do të ndiqen për “Corrective Actions” të dala nga Misioni i II i Validimit dhe masat që duhen marrë për realizimin e tyre. Administratori i Pavarur është vënë në dijeni të këtyre hapave për tu reflektuar në hartimin e Raportit EITI 2017-2018.

OBJEKTIVI ■ **ZGJERIMI I KAPACITETEVE EITI**

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të cilat janë përmendur hollësisht më sipër, në paragrafin e aktiviteteve.


OBJEKTIVI ■ **AKTIVITETE KOMUNIKIMI**

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar aktivitete të shumta komunikimi të cilat janë përmendur hollësisht më sipër, në paragrafin e aktiviteteve.



VLERËSIMI I PERFORMANCËS KUNDREJT KËRKESAVE EITI

NË PËRPTHJE ME KËRKESËN 7.4 (a) (ii)



KËRKESA EITI 1

Mbikëqyrja nga Grupi Ndërinstitucional i Punës

- 1.1 Angazhimin e qeverisë
- 1.2 Angazhimin e kompanive
- 1.3 Angazhimin e shoqërisë civile
- 1.4 Grupi Ndërinstitucional i Punës
- 1.5 Plani i Punës

MSG në Shqipëri është përfshirë në mënyrë aktive në zbatimin e EITI. Shqipëria publikuar raporte të EITI sipas afateve të përcaktuara. Anëtarët MSG janë të angazhuar në zbatimin e EITI, sipas sektorit që ata mbulojnë.

Institucionet shtetërore, pjesë përbërëse e MSG, kanë treguar angazhim të lartë duke vënë në dispozicion të Inicativës EITI strukturat dhe burimet e tyre njerëzore për Raportimin EITI.

Për arsye subjektive duke përjashtuar vetëm një numër të vogël të vonesave, kompanitë kanë treguar përkushtim ndaj procesit të raportimit dhe kanë luajtur një rol kyç në publikimin e pagesave të tyre dhe Qeveria në publikimin e të ardhurave të përfituara nga kompanitë nxjerrëse. Gjithashtu, qeveria ka vazhduar të financojë zbatimin e EITI nga buxheti kombëtar.

Gjetja e një gjuhe gjithëpërfshirëse dhe ndërtimi i një bashkëpunimi konstruktiv e bëjnë punën e MSG Shqipëri produktive. Sidoqoftë, duhet të përmendim vakumin që ndodhi me strukturën e MSG duke mos zëvendësuar disa vende nga anëtarët e OSHC-ve që me dëshirë kanë dhënë dorëheqjen.

Anëtarët e MSG nga Shoqëria Civile kanë treguar përkushtim ndaj Nismës EITI duke qenë të zëshëm në takimet për çështje të ndryshme. Ajo që u pa si shqetësim nga vitet e kaluara dhe për të cilën u punua dhe u realizua në fillim të vitit 2019 ishte mungesa dhe jo plotësimi i dy vendeve të zbrazëta të këtij grupimi në MSG të EITI. Me plotësimin e vendeve bosh në grupimin e Shoqërisë Civile në MSG dhe zëvendësimin e një anëtari, i ka dhënë një frymë të re dhe vitalitet aktivizimit të SHC në MSG dhe në implementimin e EITI në Shqipëri. Grupimi i Kompanive në MSG ka qenë si përherë i lavdërueshëm duke vijuar me të njëtin intensitet të angazhohet në çështjet e implementimit të EITI-it në Shqipëri. EITI Shqipëri, pavarësisht se ka hasur në vështirësi nga mungesa e fondeve, për shkak të arsyeve objektive të vonesës të financimit të Bankës Botërore dhe për shkak të dorëheqjes së Drejtuesit të Sekretariatit dhe emërimit të Drejtuesit të ri (proçes ky që mori disa muaj nga viti 2019) nuk e ka ndaluar punën për të arritur me sukses objektivat e

dhe në përmbushjen e aktiviteteve të përcaktuara në planin e punës.

KËRKESA EITI 2

Kuadri ligjor dhe institucional, duke përfshirë alokimin e kontratave dhe licencat

- 2.1 Kuadri ligjor dhe regjimi fiskal
- 2.2 Shpërndarja e liçensave
- 2.3 Regjistri i liçensave
- 2.4 Kontratat
- 2.5 Pronarët Përfitues
- 2.6 Pjesëmarrja e shtetit

Aktualisht, EITI Shqipëri po aprovon projektligjin "Për transparencën e aktiviteteve të industrive nxjerrëse dhe përdorimin e burimeve natyrore në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i këtij ligji është nxitja dhe sigurimi i rritjes së transparencës në aktivitetet e industrisë nxjerrëse dhe përdorimit të burimeve natyrore përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare të EITI, për të përmirësuar kuadrin ligjor për raportin e EITI dhe duke e harmonizuar atë me standardin EITI. Gjithashtu, ky Projektligj përfshin dispozita ligjore për publikimin e Pronarëve Përfitues.

Alokimet e licencave. Shqipëria ka bërë publike zonat e lira të naftës dhe kompanitë e interesuara hyjnë në negociata me qeverinë shqiptare. Liçensat minerare ofrohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në Ligjin Nr 10 304 datë 15.07.2010" Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar". Programi vjetor mineral, miratuar me V.K.M., percakton zonat minerare konkurruese dhe zonat e lira. Për zonat minerare konkurruese subjektet e interesuara i nënshtrohen një konkurimi public ku vleresimi i fituesit bëhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara me ligj. Për zonat e hapura liçensa i jepet subjektit të interesuar i cili plotëson kushtet e lejimit sipas parimit - i pari në kohë, i pari në të drejta.

Publikimi i Planit vjetor mineral dhe të gjitha procedurave konkurruese bëhet në Agjensinë e Prokurimit Publik dhe në faqen zyrtare të MIE.

Sipas raportit EITI 2016 dhe në përputhje me kërkesat 2.4.b, Shqipëria ka bërë përparim në publikimin e **kontratave** të reja të naftës dhe të të gjitha termave të konçesionit të hidroçentraleve. Projektligji i EITI propozon publikimin e kontratave. Të gjitha kontratat e konçesionit miratohen me V.K.M dhe nënshkruhen nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Pas nënshkrimit të kontratës, operatori harton një plan të hollësishëm të zbatimit. Përpara se të miratohet, ky plan përsëri i nënshtrohet kontrollit teknik të shtetit. Marrëveshjet e naftës dhe gazit u ndanë përmes procedurave ad hoc të negociatave deri në gusht 2013. Informacioni mbi të liçensuarit dhe operacionet e përbashkëta publikohen në faqen e internetit të MIE-së. Ndërtimi i termocentraleve u nënshtrohet 10-20 lejeve nga organe të ndryshme rregullatore, duke përfshirë: lejen mjedisore (vjetore), lejet e ndërtimit (para ndërtimit), lejen për shfrytëzimin e burimeve ujore (vjetore), licencën për prodhimin e energjisë (para fillimit të prodhimit), leje për t'u lidhur me rrjetin e transmisionit të energjisë etj.

Regjistri i liçencave është i disponueshëm publikisht në faqen e internetit ALBEITI: www.albeiti.org Ky regjistër rifreskohet çdo 6 muaj. Gjithashtu Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës ka publikuar një regjistër të liçencave minerare në linkun: <http://www.infrastruktura.gov.al/lejet-minerare-ekzistuese>

Në kontekstin e legjislacionit shqiptar **Pronar Përfitues** perkufizohet në Ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar, neni 2 / pika 12. si personi fizik, që zotëron ose kontrollon i fundit një klient dhe/ose personi, për llogari të të cilit kryhet një transaksion. Këtu përfshihen edhe ata persona, të cilët ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv ndaj një personi juridik. Kontroll i fundit efektiv është marrëdhënia, në të cilën një person:

- a) zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të paktën 25 për qind të aksioneve ose të votave të një personi juridik;
- b) i vetëm zotëron të paktën 25 për qind të votave të një personi juridik në bazë të një marrëveshjeje me ortakët ose me aksionarët e tjerë;
- c) përcakton de facto vendimet e marra nga personi juridik;
- d) kontrollojnë në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së administratorëve të personit juridik.

Ky ligj perkufizon gjithashtu "Personat e

eksponuar politikisht" si personat, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarin e pasurive të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, sipas përcaktimeve të legjisllacionit për shërbimin civil. Në këtë kategori përfshihen edhe individët, të cilët kanë pasur ose kanë funksione të rëndësishme në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, politikanë të lartë, zyrtarë të lartë të qeverisë, të gjykatave ose të ushtrisë, drejtues të lartë të kompanive shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike, përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi."

Qendra Kombëtare e Biznesit e cila e ushtron aktivitetin e saj bazuar në ligjin Nr.131/2015 "Per Qendrën Kombëtare të Biznesit" i ndryshuar , mbështetur në nenin 67 te tij shprehet qarte se, çdo person, ka të drejtë të marrë pa pengesa, në format elektronike, sipas dëshirës, ekstrakte për të dhënat e regjistruara të çdo subjekti. Ekstraktet mund të lëshohen për të dhëna të caktuara të subjekteve dhe/ose për historikun e veprimeve të kryera nga një subjekt.

Në ekstrakt të thjeshte apo historik, krahas shumë të dhënave, jepen edhe të dhëna të plota mbi subjektin si administrator i shoqërisë, këshilli drejtues i saj, emrat e të gjithë aksionerëve dhe % përkatëse e tyre.

Në kuadrin e përpilimit të raportit EITI 2016, MSG i kërkoi subjekteve raportuese dhe autoritetit kontaktues, MEI-it të raportojë informacion për pronarët e dobishëm sipas perkufizimeve të standartit EITI. MEI konfirmon se sot Ministria nuk disponon një regjistër sipas kërkesave të standartit EITI. Subjektet e licensuara gjithashtu nuk ishin gati për këtë raportim. Shumica e subjekteve zgjodhi të mos e plotësoj formularin duke komentuar se pronësia mbi shoqërinë paraqitej në regjistrin e QKR. Vetëm 17 raportuan pronarët e shoqërisë. Në të gjitha rastet pronarët e listuar ishin të njëjtë me çfarë ishte paraqitur

	<p>në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit</p> <p>Pjesëmarrja e shtetit a) Subjektet shtetërore në Shqipëri përcaktohen me nenin 213 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për sipërmarrësit dhe subjektet tregtare", si subjekte tregtare të zotëruara dhe të kontrolluara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga qeveria qendrore ose qeveria lokale, kurse kontrolli fuqia për të qeverisur aktivitetet e subjekteve tregtare. Ky ligj sugjeron që në rastet e çështjeve që kërkojnë shumicë të kualifikuar, Aksionerët. Përkufizimi i NSH-ve shpjegohet në Raportin EITI 2016 dhe MSG-ja është pajtuar me këtë përkufizim gjatë procesit të raportimit EITI.</p> <p>b) Niveli i pronësisë së NSH-ve është shpjeguar në Raportin EITI 2016.</p>
<p>KËRKESA EITI 3</p> <p>Kërkim-Zbulimi dhe prodhimi</p> <p>3.1 Kërkim-Zbulimi 3.2 Prodhimi 3.3 Eksportet</p>	<p>Të gjitha të dhënat e kërkim-zbulimit, prodhimit dhe eksportit janë të dokumentuara në Raportin e EITI Albania dhe gjenden të publikuara në faqen e internetit www.albeiti.org</p>
<p>KËRKESA EITI 4</p> <p>Mbledhja e të ardhurave</p> <p>4.1 Publikim i detajuar i taksave dhe të ardhurave 4.2 Shitja e pjesës së shtetit të prodhimit ose të ardhurave të tjera të mbledhura në natyrë 4.3 Dispozitat e infrastrukturës dhe marrëveshjet e shkëmbimit 4.4 Të ardhurat nga transporti 4.5 Transaksionet që kanë të bëjnë me ndërmarrjet shtetërore 4.6 Pagesat në nivel kombëtar 4.7 Niveli i ndarjes 4.8 Koherenca e të dhënave 4.9 Cilësia dhe siguria e të dhënave</p>	<p>Publikim i detajuar i taksave dhe të ardhurave Sistemi i taksave që zbatohet në Shqipëri për sektorin e industrisë nxjerrjese është e njëjtë që zbatohet për ekonominë e gjithë vendit, TVSH, taksat e fitimit, dividendët + renta, bonuse dhe pagesa të tjera të rëndësishme dhe përfitime materiale për qeverinë. Qiraja minerare nga qeveria shihet si një taksë për zhvillimin e kësaj zone. Për të dhënë impuls ose zhvillim në industrinë e përpunimit në vend, qeveria zvogëloi rentën për kromit e përpunuar (ferrochrome) nga 6 në 3 për qind. Raporti i EITI tregon një përmbledhje gjithëpërfshirëse tatimore të mbledhur nga qeveria për vitin 2016.</p> <p>Shitja e pjesës së shtetit të prodhimit ose të ardhurave të tjera të mbledhura në natyrë Në Raportin EITI 2016 janë shpalosur të hyrat e mbledhura në natyrë nga Albpetrol.</p> <p>Marrëveshjet për Sigurimin e Infrastrukturës Raporti i EITI 2016 përfshin një vlerësim të</p>

zbatueshmërisë së dispozitiveve të infrastrukturës dhe aranzhimeve të këmbimit në sektorët e naftës dhe minierave, të përshkruara respektivisht në kapitullin 3 dhe 4.

Të ardhurat nga transporti Shteti Shqiptar nuk merr taksë tranziti. Tubacionet e Albpétrol nuk janë funksionale. Dy tubacione për transportin e naftës së papërpunuar lidhin terminalin e naftës së ARMOs në Vlorë me rafineritë e Fierit dhe Ballshit si dhe dy rafineritë mes tyre. Të dy tubacionet janë jashtë funksionit për shkak të vjetërimit. Në total, rrjeti i tubacioneve të naftës ka një gjatësi prej 188 km dhe kapacitet prej 2.5 milion ton në vit.

Trans Adriatic Pipeline (TAP) AG është një bashkim i disa shoqërive ndërkombëtare themeluar me qëllim planifikimin, zhvillimin dhe ndërtimin e gazsjellësit natyror TAP. Qeveria shqiptare ka hyrë në bisedime me koncorciumin e TAP për vendosjen e një takse Tranziti. TAP është aktualisht kontribuesi më i madh i investimeve të huaja direkte në vend. Siç është vendosur në Marrëveshjen e Qeverisë Pritëse midis TAP dhe Qeverisë Shqiptare, TAP do të shpenzojë 14 milionë euro në infrastrukturë dhe investime të tjera në dobi të shoqërisë civile dhe komuniteteve.

Transaksionet që kanë të bëjnë me ndërmarrjet shtetërore. Albpétrol i paguan taksa qeverisë, siç zbatohet për të gjitha kompanitë komerciale të naftës dhe dividendët në cilësinë e aksionarit të vetëm të kompanisë. Të dy Albpétrol dhe MIE njoftuan se nuk ka marrëveshje të posaçme që rregullojnë transferimet nga Albpétrol në Qeveri dhe anasjelltas. Albpétrol ka qenë fitimprurës deri më tani, pavarësisht bazës së madhe të kostos së punonjësve. Financat e Albpétrol tregojnë rezultate të luhatshme të fitimit. Të ardhurat rrjedhin kryesisht nga shitja e naftës në dispozicion. Albpétrol nuk ka marrë, as nuk ka dhënë hua për Qeverinë deri tani.

Pagesat lokale Renta mblidhet nga shitjet e tatueshme të naftës, gazit dhe mineraleve dhe regjistrohen në Buxhetin e Shtetit. Sipas Ligjit për taksat kombëtare nr. 9975, datë 28 korrik 2008, ndryshuar, një pjesë e tatimit mbi të drejtën e rentës do të ndahet për secilën njësi të qeverisjes vendore ("NJQV") në

proporcion me kontributin e tyre në prodhimin e brendshëm të naftës, gazit dhe minerareve.

Cilësia dhe siguria e të dhënave, Standardet e Aplikuara të Kontabilitetit Dispozitat aktuale rregullatore në Shqipëri kërkojnë që subjektet e përfshira të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) ose Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (IAS), të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për shpenzimet e kontabilitetit dhe raportimi ligjor .

Standardet e Auditimit të Aplikuara Të gjitha subjektet, përfshirë shoqëritë aksionare pjesëmarrëse ("SHA") dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar ("SHPK") janë subjekt i auditimit ligjor, duke përjashtuar ato SHPK të klasifikuara si njësi më të vogël.

LIGJ-in Nr.10 091, datë 5.3.2009 "PËR AUDITIMIN LIGJOR, ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË AUDITUESIT LIGJOR DHE TË KONTABILISTIT TË MIRATUAR" (ndryshuar me ligjin nr.10 297, datë 8.7.2010, nr. 47/2016, datë 28.4.2016, konkretisht. Neni 41, Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare (ndryshuar shkronja "c", me ligjin nr. 47/2016, datë 28.4.2016) Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese:

a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;

b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit;

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

I - totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e

kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
ii - shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii - ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

Sqarojmë se subjektet minerare që raportojnë në Raportin EITI janë përgjithësisht shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe një pjesë e konsiderushme e tyre nuk plotësojnë kushtin që i detyron të auditojnë bilancet e tyre nga ekspert të pavarur.

Niveli i ndarjes paraqitet në Shtojcën 1, 2, 3 të Raportit EITI 2016.

Afati kohor i të dhënave

Raporti i EITI 2016 është prodhuar dhe publikuar në përputhje me kërkesat e EITI, më 15 shkurt 2018.

Koherenca e të dhënave Raporti EITI 2016 ofron një vlerësim të procedurave të sigurimit të kryera në numrat e raportuara nga subjektet qeveritare dhe të liçencuarit në këtë raport. Kapitulli 10, jep detajet e harmonizimit të flukseve për vitin 2016 dhe liston të gjitha subjektet që nuk raportojnë në 2016, duke përfshirë publikimin e ndikimit bazuar në raportimin e njëanshëm nga njësitë qeveritare.

Rekomandimet për përmirësime janë gjithashtu të listuara në Raportin EITI 2016.

MSG Shqiptare po harton dhe aprovon një plan veprimi për ndjekjen e Rekomandimeve të EITI 2016, kështu që të gjitha kërkesat do të mbulohen për të përmirësuar raportimin EITI në Shqipëri.

KËRKESA EITI 5

Shpërndarja e të ardhurave

- 5.1 Shpërndarja e të ardhurave të industrisë nxjerrëse
- 5.2 Transfertat në nivel kombëtar
- 5.3 Manaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

Shpërndarja e të ardhurave nga industria nxjerrëse Renta mblidhet nga shitjet e tatueshme të naftës, gazit dhe mineraleve dhe regjistrohen në Buxhetin e Shtetit. Sipas Ligjit për taksat kombëtare nr. 9975, datë 28 korrik 2008, ndryshuar, një pjesë e tatimit mbi të drejtën e rentës do të ndahet për secilën njësi të qeverisjes vendore ("NJQV") në proporcion me kontributin e tyre në

prodhimin e brendshëm të naftës, gazit dhe minerareve. Kuadri rregullator për transfertat lokale të rentës deri në nëntor të vitit 2014, Ligji për taksat kombëtare kërkoi që 25% e rentës të ndahet për secilën njësi të qeverisjes vendore ("NJQV") në proporcion me kontributin e tyre, brenda afatit të të ligjit të buxhetit vjetor. Formula për ndarjen e rentës në NJQV-të përfituese nuk është publikuar dhe transferimet e bëra nuk mund të lidhen me kontributin e NJQV-ve në mbledhjen e rentës. Deri në vitin 2014, vetëm vendet që prodhojnë naftë mund të përfitojnë nga transferimet lokale të rentës.

Më 27 nëntor 2014, Qeveria Shqiptare paraqiti ndryshime në Ligjin për Taksat Kombëtare, ku NJQV-të kanë të drejtë të marrin 5% të rentës së gjeneruar nga shitjet e naftës dhe mineraleve të nxjerra në zonën e tyre. Sipas këtyre kushteve të reja, transfertat e rentës lidhen me kontributin e NJQV-ve dhe nuk ndikohet nga ndonjë transferim tjetër buxhetor në përputhje me ligjin vjetor të buxhetit. Udhëzimi nr. 26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar ("udhëzimi"), liston procedurat e barazimit që duhet të kryhen nga NJQV-të përfituese për të siguruar alokimin e drejtë të rentës. Prandaj, çdo NJQV do të bjerë dakord që në fund të muajit pagesat e rentës të bëra nga të liçencuarit që veprojnë në zonën e NJQV-së, me drejtorinë rajonale të taksave dhe doganave. Drejtoritë rajonale të taksave dhe doganave duhet të dorëzojnë listën analitike të NJQV-ve të mbledhura dhe të përfituara nga reduktimi i të ardhurave në Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financave ("MF"). Pas marrjes së rakordimit, MF fillon transferimet mujore të rentës të autorizuara në NJQV. Në rastin e kompanive të naftës, të cilat veprojnë në të njëjtën kohë në disa NJQV, udhëzimi përcakton pjesën e rentës që do të ndahet.

Aktualisht, qeveria shqiptare po shqyrton përsëri përqindjen e rentës që do të transferohet në NJQV.

Transfertat në nivel kombëtar. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është në proces përmirësimi të procedurave në mënyrë që të sigurohet për saktësinë dhe plotësinë e shpërndarjes së rentës në përputhje me kërkesat e reja ligjore. Sipas ndryshimeve të bëra, gjatë vitit 2015 NJQV-të kanë të drejtë të marrin 5% të rentës minerare të gjeneruara nga Shoqëritë që prodhojnë në zonën e tyre

pa marrë parasysh ndonjë transferim të parashikuar në përputhje me ligjin e buxhetit vjetor. Udhëzim Nr.26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar përcakton procedurat rakorduese për alokimin e rentës minerar. Sipas këtij udhëzimi, NJQV-të në duhet të kryejnë rakordimet me drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave në fund të cdo muaji dhe të nisin këto rakordime pranë

Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Njëkohësisht drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave duhet të dergojnë brenda muajit informacion analitik për rentën e mbledhur dhe NJQV-të përfituese. Mbi bazën e rakordimeve Ministria e financave kryen transfertat e rentës NJQV-ve përfituese në muajin pasardhës.

Për shoqëritë e naftës, veprimtaria e të cilave shtrihet në disa NJQV njëkohësisht, udhëzimi përcakton përqindjen e rentës që do t'i shkojë çdo NJQV-je në varësi të vendburimit ku është prodhuar nafta apo gazi i shitur.

Manaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat e mbledhura nga Buxheti Shtetit nga industria nxjerrëse bashkohen me të ardhurat e tjera në buxhet dhe alokohen natyrshëm nëpër zërat e buxhetit. Nuk ka alokim specifik të këtyre të ardhurave në programe të buxhetit me përjashtim të Rentës Minerare ku 5% i kalon pushtetit vendor sipas zonave ku ushtron aktivitetet industria nxjerrëse. Njëkohësisht këto të ardhura përbëjnë rreth 5% të Buxhetit.

AKBN menaxhon vetë një pjesë të të ardhurave nga Marrëveshjet Hidrokarbure. Deri tani AKBN nuk ka dhënë informacion se si alokohen këto të ardhura në buxhetin e saj. Shteti shqiptar mbledh të ardhura nga sektori i naftës dhe gazit nëpërmjet ndarjes së prodhimit të naftës, bonuset, rentën minerare, tatimit mbi fitimin dhe dividend, të ardhura nga punësimi. Në raport tregohet shpërndarja e të ardhurave totale të gjeneruara nga operacionet e naftës midis Qeverisë Shqiptare, shoqërisë Albpetrol, AKBN-së dhe shoqërive private të naftës. Interesi i Shtetit Shqiptar në PSA administrohet nga Albpetrol dhe AKBN, të cilat marrin nga PSA-të: bonuse, pjesë nga prodhimi i naftës dhe të ardhurave të tjera që rrjedhin nga mos-zbatimi i termave të kontratave si gjoha dhe garanci të ekzekutuara. MIE publikon

informacion financiar lidhur me shpenzimet sipas natyrës dhe programit në faqen e saj të internetit <http://infrastruktura.gov.al/>

KËRKESA EITI 6

Shpenzimet sociale dhe ekonomike

- 6.1 Shpenzimet sociale nga kompanitë nxjerrëse
- 6.2 Shpenzimet fiskale
- 6.3 Kontributi i sektorit nxjerrës në ekonomi

Shpenzimet sociale janë shpenzime materiale të bëra nga kompanitë ne sektorin e Industrive Nxjerrëse në dobi të publikut dhe shoqërisë civile, siç është mandatuar me ligj ose me kontratën me qeverinë.

Qeveria dhe kompanitë e naftës të përfshira në sektorin e naftës informuan se aktualisht Marrëveshjet në fuqi të naftës nuk përfshijnë pagesa sociale të detyrueshme që duhet të kryhen nga kompanitë e naftës në dobi të komuniteteve.

Koha dhe shuma e pagesave sociale vendosen nga kompanitë e naftës në diskrecionin e tyre.

Shoqëritë duhet t'i paraqesin këto shpenzime për AKBN/ Albpetrol për miratim si pjesë e miratimit vjetor të buxhetit.

Shpenzimet fiskale. MSG Shqipëri diskutoi në takim të datës 12.02.2019 ekzistencën e shpenzimeve kuazi-fiskale në Shqipëri dhe materialitetin e tyre. Deklarata e MSG për këtë çështje do të dërgohet veçmas në Sekretariatit Ndërkombëtar dhe do të mbulohet në Raportin e ardhshëm EITI.

Kontributi i sektorit nxjerrës në ekonomi.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga agjencitë qeveritare të paraqitura në Raportin e EITI 2016, sektori nxjerrës dhe hidroenergji llogariten në mënyrë kolektive jo më shumë se 6% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2016, në shumën 87,483 milionë lekë. Eksportet nga sektori nxjerrës janë rritur ndjeshëm me mbi 100% deri në vitin 2013, kur arritën në 96.7 miliardë lekë ose 39% të totalit të eksporteve. Kjo përqindje ka rënë në 19% të totalit të eksporteve në vitin 2016 ose 47.0 miliardë lekë, ndikuar njëkohësisht nga rënia e çmimeve ndërkombëtare për naftën dhe rritja e aktivitetit të rafinimit të naftës në vend. Bazuar në të dhënat e raportuara nga DPT, mbajtësit e licencave të përfshirë në sektorin nxjerrës në sektorin e naftës, minerareve dhe

hidrocentraleve kanë të punësuar përafërsisht 16,500 staf ku përbëjnë 1.4% të fuqisë punëtore të regjistruar nga INSTAT në dhjetor 2016.

KËRKESA EITI 7

Rezultatet dhe ndikimi

- 7.1 Debati publik
- 7.2 Aksesueshmëria e të dhënave
- 7.3 Mospërputhjet dhe rekomandimet nga Raportet EITI
- 7.4 Shqyrtimi i rezultateve dhe ndikimin e zbatimit të EITI

Debat publik.Raporti EITI në Shqipëri është i kuptueshëm dhe i aksesueshëm publikisht. Të dyja Raportet EITI dhe Skeda e Përmbledhjes së të Dhënave janë në dispozicion në format të hapur të të dhënave. Gjithashtu, kopjet e raporteve EITI prodhohen vazhdimisht dhe u shpërndahen palëve të interesuara. Raportet publikohen në faqen e internetit www.albeiti.org në gjuhën shqipe dhe angleze.

Raporti i EITI Shqipëri është përdorur gjerësisht nga palët e interesuara në debate publike. Organizimi i takimeve me gazetarët nga mediat vendore dhe kombëtare, edicionet, shkrimet kronike dhe organizimi i takimeve me grupet e interesit vendore dhe të huaja, tregojnë qartë angazhimin e MSG dhe Sekretariatit Kombëtar EITI për të nxitur një debat publik mbarëkombëtar dhe për të ndikuar në zhvillimin ekonomik dhe social të komuniteteve.

Aksesueshmëria e të dhënave. Sekretariati Kombëtar EITI publikon raportet e EITI në faqen e saj të internetit dhe të gjitha palët e interesuara kanë qasje të plotë për të dhënat e kërkuara. Kopjet fizike të Raporteve EITI dhe Raporteve Përmbledhëse shpërndahen gjerësisht tek palët relevante të interesit.

Mospërputhjet dhe rekomandimet nga Raportet EITI. Mospërputhjet dhe rekomandimet në Raportet EITI diskutohen në mbledhjet e MSG. Kohët e fundit Sekretariati Kombëtar propozoi që brenda MSG të krijohej një nëngrup i përhershëm. Ky grup do të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të Raportit EITI dhe gjithashtu veprimet korigjuese të ngritura nga Validimi deri në përmbushjen e tyre të plotë.

Shqyrtimi i rezultateve dhe ndikimin e zbatimit të EITI.Për të kapërcyer pengesat që dalin në këtë drejtim, Sekretariati Kombëtar EITI dhe MSG kanë punuar ngushtë me palët e përfshira në proces. Shumë nga aktivitetet e komunikimit dhe promovimit me të gjithë

aktorët u kryen nga Sekretariati Kombëtar EITI dhe MSG.

Miratimi i Ligjit për Transparencën është premtuese, por në të njëjtën kohë kërkon koordinim të punës nga palët e përfshira.

2020 do të jetë viti i publikimit të Pronarëve Përfitues dhe si anëtar i EITI, Shqipëria po ndjek hapat e duhur për të përmbushur këtë detyrim global. Një udhërrëfyes i Pronarëve Përfitues për të gjitha hapat që duhen ndjekur është botuar në janar 2017. Sekretariati Kombëtar i EITI ka kryer dhe po kryen të gjitha aktivitetet e parashikuara në këtë udhërrëfyes. Projektligji "Për transparencën e aktiviteteve të industrive nxjerrëse dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore në Republikën e Shqipërisë" përfshin dispozita ligjore për shpalljen e Pronarëve Përfitues.

Shumë takime janë kryer nga Sekretariati Kombëtar i EITI dhe kohët e fundit nga OShC-të, anëtarët e MSG-së, me Njësitë e Qeverisjes Vendore në fushat ku operojnë industritë nxjerrëse, kompanitë dhe përfaqësuesit e shoqërive civile, për të promovuar EITI-dhe Raportimin EITI.

Nga ana tjetër, janë organizuar takimeve me gazetarë nga media kombëtare dhe lokale. Informimi i medias mbi punën dhe misionin e iniciativave EITI është një rrugë që pasqyron një angazhim serioz për transparencën në sektorin nxjerrës.

Risia që solli organizimi i Anketimi EITI ishte për Sekretariatit Kombëtar EITI mënyra më e mirë për të analizuar perceptimin e publikut për ndikimin dhe zbatimin e EITI në Shqipëri.

Rezultatet e sondazhit treguan se administrata lokale dhe qendrore (e prekur nga raportimi EITI) nuk kishin informacion mbi kërkesat e EITI.

Si rezultat, Sekretariati Kombëtar i EITI vendosi që aktivitetet e parashikuara në Planin e Punës do të luanin një rol kyç në organizimin e aktiviteteve informuese kryesisht duke u fokusuar në këtë grup.

Mund të shprehim se qeveria vendore (kur operon industria nxjerrëse) dhe administrata qendrore duke iu përgjigjur me kohë dhe me cilësi kërkesave dhe detyrimeve të Nismës EITI dëshmon që Plani i Punës EITI ka arritur objektivin në këtë drejtim.

Rritja progresive e kompanive raportuese në EITI. Gjatë viteve, përqindja e raportimit nga kompanitë nxjerrëse u rrit në mënyrë progresive, duke synuar një përfshirje më të madhe të sektorëve.

I. Në sektorin e naftës për Raportet EITI kanë raportuar 100% të kompanive që operojnë në këtë sektor.

II. Në sektorin e minierave, numri i kompanive është rritur nga viti në vit dhe përqindja e prodhimit të realizuar nga këto kompani në terma konkretë është:

1. Në vitin 2012, 69 kompani, duke raportuar 77.1% të prodhimit minerar.

2. Në 2013, 81 kompani, duke raportuar 85% të prodhimit të minierave.

3. Në vitin 2014, 99 kompani, që raportojnë 87% të prodhimit minerar.

4. Në 2015, 105 kompani, që raportojnë 89% të prodhimit minerar.


5. Në 2016, 128 kompani raportuan, 90% të prodhimit të minierave.

III. Në sektorin e energjisë elektrike kanë raportuar kompanitë kryesore që veprojnë në këtë sektor.

1. Në vitin 2015, 13 kompanitë, që raportojnë 90% të prodhimit të energjisë elektrike.


2. Në 2016, 12 kompani, që raportojnë 90% të prodhimit të energjisë elektrike.

Ndryshimet e shpeshta brenda stafit në disa prej institucioneve kanë shkaktuar konfuzion dhe vështirësi, por qasja miqësore midis palëve ka sjellë në rezultate konkrete.



**PËRMBLEDHJE E PËRGJIGJEVE TË MSG PËR REKOMANDIMET NGA
RAKORDIMI DHE VALIDIMI, NËSE ËSHTË E APLIKUESHME**

NË PËRPUTHJE ME KËRKESËN 7.4. (a)(iii)



MSG-ja gjatë gjithë vitit 2019 ka diskutuar vazhdimisht dhe ka marrë masa për veprimet korrigjuese të dala nga proçesi i Validimit të Dytë dhe nga vendimi i Bordit EITI në lidhje me Validimin e Shqipërisë.

Një përmbledhje të shkurtër të masave të marra i gjeni të renditura si më poshtë:

VEPRIMI KORRIGJUES 1 (#1.3)

Shoqëria civile në përputhje me veprimin korrigjues Nr. 1.3 ka draftuar dhe dorëzuar brenda afatit të përcaktuar nga Bordi Ndërkombëtar EITI, 13 Maj 2019, Planin e veprimit dhe pse pak para fillimit të Validimit të dytë por brenda afatit, ka organizuar zgjedhjet e reja duke përcaktuar anëtarët e saj të rinjë në MSG. Koordinimi mes anëtarëve të shoqërisë civile, përfaqësues në MSG është përmirësuar dhe është rritur edhe kapaciteti i grupimit të shoqërisë civile në 12 shoqata.

VEPRIMI KORRIGJUES 2 (1.4.a.ii, 1.4.b.ii, 1.4.b.iii 1.4.b.vi)

Në përputhje me kërkesën 1.4.a.ii dhe 1.4.b.vi, MSG-ja ridiskutoi proçedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të MSG-së dhe me Vendimin Nr. 2, date 15.05.2019, dakordësoi ndjekjen me rigorozitet të proçedurave të përzgjedhjes të anëtarëve të parashikuara në Rregulloren e Brendëshme të MSG-së dhe vlerësimin e tyre. Gjithashtu të gjithë grupet e interesit të përfshirë në MSG publikuan proçedurat e përzgjedhjes së anëtarëve në website-et përkatëse: www.albeiti.org ; [www. http://fiaalbania.al/](http://fiaalbania.al/); [www. albneteiti.org](http://www.albneteiti.org);


Në lidhje me prezencën e Albpetrolit në MSG, gjatë vitit, Albpetrol sh.a. u bë anëtar me të drejta të plota në MSG në grupimin e kompanive të industrisë nxjerrëse.

MSG-ja në bashkëpunim me Sekretariatit EITI Shqipëri dhe Shoqëria Civile gjatë vitit 2019 kanë ndërmarrë aktivitete të ndryshme komunikimi duke informuar palët e interesit për implementimin e EITI-t në Shqipëri.

VEPRIMI KORRIGJUES 3 (#2.2)


Shqipëria ka bërë një punë dhe një progres të kënaqshëm në lidhje me publikimin e dhënies dhe transferimit të liçensave. Përveç publikimit të tyre në QKB, një punë e madhe është bërë nga ana e MSG-s dhe Sekretariatit EITI Shqipëri për plotësimin e informacionit dhe publikimin e tij në website-in, www.albeiti.org


Duke u bazuar në Raportin Final të Validimit të II-të dhe mbasi janë kontrolluar hapat e ndërmarra për të adresuar 12 Corrective Actions, nga Misioni i Validimit II i është sugjeruar Bordit EITI që të marrë në konsideratë edhe veprimet e ndërmarra mbas fillimit të Misionit të II të Validimit (13 shkurt 2019). Në një rast të tillë Shqipëria ka adresuar plotësisht 7 nga 12 Corrective Actions, duke pasur “progress të kënaqshëm” dhe në kërkesat e tjera ka “progress domethënës” me përmirësime të konsiderueshme.



NDONJË PIKË E FORTË OSE DOBËSITË E IDENTIFIKUARA NË PROÇESIN EITI

NË PËRPTHJE ME KËRKESËN 7.4. (a)(v)







PIKË E FORTË

Kooperimi me Institucionet Ndërkombëtare lidhur me problematikat e nxitjes së Transparencës dhe mirëadministrimit të Rentës Minerare, në funksion të impaktit social, ekonomik dhe mjedisor ne Komunitet lokale për një zhvillim të qëndrueshëm.




DOBËSITË

Mosrealizimi kohor i aktiviteteve konform afateve të parashikuara në Planin e Punës përshkak të vonesës së fondeve të financuara nga grant i Bankës Botërore.





ZBATIMI I PLANEVE PËR PUBLIKIMIN E PRONARËVE PËRFITUES

NË PËRPUTHJE ME KËRKESËN 7.4. (a)(vi)




Janë finalizuar dhe aprovuar nga Banka Botërore ToRs për Raportimin dhe Regjistrin e Pronarëve Përfitues (Beneficial Ownership) sipas procedurave të prokurimit të Bankës Botërore.

Për shkak të vonesave objektive për miratimin dhe disbursimin e fondeve të Grantit të Bankës Botërore nga i cili do të realizohej ky aktivitet (Granti është miratuar formalisht vetëm në datën 30 Prill 2020), dhe në vijim për shkak të bllokimit të punës krijuar nga shpallja e gjëndjes së pandemisë COVID-19, procedura e prokurimit për aktivitetin pritet të shpallet së shpejti dhe të finalizohet brenda vitit 2020.



KOSTOJA TOTALE E IMPLEMENTIMIT





Sekretariati Kombëtar EITI për vitin 2019 u financua nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe nga fondet e Projektit Grant TF0A1769 i Bankës Botërore.

Financimi nga Buxheti i Shtetit ishte në shumën 10.900.000 Lekë dhe mbuloi shpenzimet e pagave dhe sigurimeve të personelit si dhe u përdor për shpenzime operative.


Projekti Grant TF0A1769 i Bankës Botërore u përdor në shumën 17.477 USD për pagesat e konsulentëve të kontraktuar nën këtë Grant.

Stafi faktik i Sekretariatit Shqiptar EITI për vitin 2019 është 9 punonjës, nga të cilët 8 punonjës me kohë të plotë dhe 1 punonjës me kontratë nga kontigjenti i studentëve të rinj të sapo diplomuar, kundrejt 9 punonjësve që ka Organigrama.





ËSHTË DISKUTUAR VEPRIMTARIA E RAPORTIT PËRTEJ MSG-SË

NË PËRPTHJE ME KËRKESËN 7.4.b






MSG gjatë vitit 2019 nuk publikoi Raportin EITI por theksojmë se arsyhet që tashmë janë shpjeguar gjatë gjithë ecurisë së Raportit të Progresit Vjetor janë ndarë me të gjitha grupet e interesit.



DETAJE MBI ANTARËSINË E MSG



Grupimi i Shoqërisë Civile në MSG për shkak të mungesës së fondeve nuk arriti të organizoj zgjedhjet e këtij grupimi gjatë vitit 2018 por arriti ti plotësoj vëndet vakante në 12 Shkurt 2019 dhe antarët e rinj u prezantuan gjatë takimit të MSG organizuar po në të njëjtën datë.

Një nga rekomandimet e dala nga Proçesi i Validimit 2018 për Shqipërinë ishte dhe prezenca e kompanisë me Kapital Shtetëror, Albpetrol, si anëtar me të drejtë vote, kërkesë e cila u pranua dhe u miratua unanimitisht nga MSG.

Axhenda e takimeve, Minutat e Takimit, Listë Prezenca dhe Vendimet e MSG për periudhën 2019 gjenden në faqen zyrtare të internetit të EITI Shqipëri <http://www.albeiti.org/viti-2019/>.






FOTO NGA AKTIVITETET





E APROVUAR NGA MSG **QERSHOR 2020**

